

L I G J
Nr.7936, datë 18.5.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE” NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7675, DATË 2.3.1993, LIGJIN NR.7792, DATË 9.2.1994, LIGJIN NR.7794, DATË 14.2.1994, LIGJIN NR.7825, DATË 18.5.1994 DHE LIGJIN NR.7844, DATË 13.7.1994

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Gërma “g” e nenit 3 të ligjit nr.7675, datë 2.3.1993 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” shfuqizohet. Në po këtë nen gërma “h” riformulohet si më poshtë:

“Për medikamentet.”

Neni 3 i ligjit nr.7733, datë 27.7.1993 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” riformulohet si më poshtë:

“Për mallrat e importuara në kuadër të marrëveshjeve shtetërore që ratifikohen nga Parlamenti, ku parashikohen shprehimisht përjashtimet nga taksat doganore si dhe ato përjashtime që janë miratuar në ligje të veçanta.

Për makineritë e pajisjet e importuara në formë investimi në kuadër të kontratave të lidhura me partnerët e huaj, dhe për të cilët janë depozituar dosjet e investimit pranë degëve doganore para datës 1 maj 1995, do të vazhdojnë ta përfitojnë përjashtimin nga taksat doganore edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në kryerjen e plotë të atij investimi të miratuar”.

Neni 2

Ligji nr.7732, datë 20.7.1993 “Për vendosjen e mbitaksës doganore për mallrat e importit”, shfuqizohet.

Neni 3

Sistemi tarifar ndryshon sipas nomenklaturës së mallrave në aneksin bashkëngjitur këtij ligji. Lista nr.2 e grupmallrave me tarifatat doganore përkatëse, si dhe shënimi poshtë saj, që janë pjesë përbërëse e ligjit nr.7733, datë 20.7.1993, shfuqizohen.

Ligji nr.7792, datë 9.2.1994 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.752, datë 13.1.1994 “Për një ndryshim në ligjin nr.7733, datë 20.7.1993; “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” shfuqizohet.

Neni 3 i ligjit nr.7793, datë 14.2.1994, shfuqizohet.

Neni 4

Për domatet, specat, patëllxhanet, bamjet, karotat dhe trangujt, për periudhën 1 maj deri më 30 tetor, vendoset taksa sezonale prej 25%. Për periudhën tjetër ruhet taksa normale e pasqyruar në nomenklaturë.

Për preshtë, lakrat, qepët, hudhrrat dhe lulëlakrat, për periudhën 1 nëntor deri më 30 mars, vendoset taksa sezonale prej 25 për qind. Për periudhën tjetër ruhet taksa normale e pasqyruar në nomenklaturë.

Neni 5

Të gjitha aktet e tjera nënligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 6

Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzimet përkatëse për këtë ligj si dhe shënimet shpjeguese të nomenklaturës së mallrave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ngarkohet të botojë një variant të përmbledhur të ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” me ndryshimet përkatëse.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 1995.

Shpallur me dekretin nr.1114, datë 31.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha